

NEWSLETTER

Mars

**8 Marsi – Dita
Ndërkombëtare e
Gruas**

**Zgjerimi i Rrjetit
– Dega e Re në
Pallatin me
Shigjeta**

**Bashkë për
Sigurinë –
Çdo Ditë Më
Afër Jush**

**Vijimi i
Trajnimeve
“Albsig Invest”
– Investim i
vazhdueshëm në
profesionalizëm**

**Dëmet e
Paguara – Një
tregues i
angazhimit tonë
real ndaj
klientëve**



 **ALBSIG**

PJESË E  KASTRATI GROUP

Shoqëria e Sigurimit Albsig sh.a., pjesë e Grupit KASTRATI, ushtron aktivitet të suksesshëm që nga viti 2004, në cilësinë e siguruesit të Jo - Jetës. Me një rrjet me 31 degë, Albsig mbulon territorin e Republikës së Shqipërisë. Albsig mbështetet në stafin e dedikuar dhe profesional dhe ofron shërbim të shpejtë dhe cilësor.

VIZIONI

Klienti, prioriteti ynë. Ne tejkalojmë pritshmëritë e tij përmes shërbimit, integritetit dhe profesionalizmit.

MISIONI

Të jemi zgjedhja e parë e çdo klienti. Ne rritemi bashkë me klientët tanë.

FILOZOFIA

Besim dhe solidaritet me klientët për të arritur suksesin e përbashkët.



Partneri juaj i sigurtë!



PJESË E  KASTRATI GROUP





Mars

**Dita
Ndërkombëtare
e Gruas**



Në këtë muaj të veçantë, ALBSIG i kushton një vëmendje të veçantë figurës së gruas, duke vlerësuar rolin e saj të pazëvendësueshëm në familje, shoqëri dhe jetën profesionale.

Nën moton "Ne jemi autentike, të pavarura, të suksesshme, frymëzuese", ne festuam së bashku me koleget tona një 8 Mars të mbushur me energji pozitive, frymëzim dhe mirënjohje. Secila prej tyre është unike dhe e veçantë, por të gjitha përfaqësojnë një forcë të përbashkët që sfidon çdo kufi.

Ashtu si Femra, edhe ALBSIG beson në forcën, pavarësinë dhe sukseset që ndërtohen çdo ditë me përkushtim dhe vizion.

Zgjerimi i Rrjetit – Dega e Re në Pallatin me Shigjeta

Për të qenë gjithmonë më pranë klientëve tanë, ALBSIG ka zgjeruar rrjetin e degëve me një pikë të re shërbimi në një nga zonat më të frekuentuara të kryeqytetit — Pallati me Shigjeta.





Kjo degë moderne do të ofrojë të gjitha shërbimet e sigurimit, me të njëjtin profesionalizëm, shpejtësi dhe korrektësi që na karakterizon. Stafi i përgatitur dhe ambienti mikpritës e bëjnë këtë degë një tjetër hap konkret drejt qëllimit tonë: t'i japim çdo klienti një eksperiencë të kënaqshme dhe të sigurt në çdo ndërveprim me ALBSIG.

Ju mirëpresim!





Vijimi i Trajnimeve “Albsig Invest” – Investim i vazhdueshëm në profesionalizëm

Trajnimet e brendshme përmes programit “Albsig Invest” kanë vijuar edhe gjatë muajit Mars, me një pjesëmarrje aktive nga stafi i degëve dhe drejtorive. Ky cikël trajnimesh synon rritjen e kapaciteteve profesionale, forcimin e aftësive komunikuese dhe menaxhimin e situatave të ndryshme me klientët, me qëllim rritjen e cilësisë së shërbimit dhe besueshmërisë në treg.

ALBSIG beson se investimi më i mirë është ai që bëhet te njerëzit – dhe përmes “Albsig Invest” ne sigurojmë që çdo anëtar i ekipit tonë të ndjehet i vlerësuar dhe i pajisur me njohuritë më të fundit të fushës.






Dëmet e Paguara:


Një tregues i angazhimit tonë real ndaj klientëve

Një nga elementët që na dallon në treg është angazhimi ynë i vazhdueshëm për zgjidhje të shpejta, të drejta dhe transparente të dëmeve të klientëve tanë. Për vitin aktual, ALBSIG regjistron numrin më të ulët të dëmeve pezull në treg, duke reflektuar efikasitetin dhe përkushtimin e stafit tonë në menaxhimin e çdo kërkesë për dëmshpërblim.

Gjatë muajve të fundit, kemi adresuar me prioritet një gamë të gjerë dëmsh — që nga dëmet në pasuri të paluajtshme dhe biznese, deri te dëmet e ndodhura në automjete apo shëndet. Në çdo rast, kemi vepruar me profesionalizëm dhe kujdes të veçantë, duke u siguruar që çdo klient, pavarësisht profilit apo nevojës, të marrë mbështetjen e duhur në kohën më të nevojshme.

Dekoll






Vilë Private në Kukës





Hotel në Theth



Spitali Lezhë




Kodra Mbretërore



Marketi Esseal



Shtëpi pushimi në Golem



Ky përkushtim është pjesë e misionit tonë për të qenë gjithmonë pranë jush, jo vetëm në momentin e nënshkrimit të policës, por edhe në çastet më të vështira, kur sigurimi merr kuptimin e tij të plotë.

BASHKË PËR SIGURINË ÇDO DITË MË AFËR JUSH

ALBSIG mbetet e përkushtuar për të qenë një partner i besueshëm dhe i pandashëm për të gjithë klientët tanë — individë dhe biznese. Çdo hap i ri që ndërmarrim, çdo degë që hapim, çdo shërbim që përmirësojmë, është në funksion të nevojave dhe pritshmërive tuaja.

Na ndiqni në rrjetet tona sociale për të mësuar më shumë mbi fushatat, shërbimet dhe historitë frymëzuese që tregojnë pse gjithnjë e më shumë shqiptarë zgjedhin ALBSIG.





 +355 (0) 42254770 / 764

 info@albsig.al

WWW.ALBSIG.AL